

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajllloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.G. nga fsh. ..., kom. ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.130/18 të datës 29.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 29.03.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E.G.** nga babai R. dhe nëna R., e lindur ., i lindur më dt. ... në ..., me vendbanim në fsh. ..., kom. ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

sepse më dt. 17.01.2018 rreth orës 00:03 minuta, në territorin e fsh. ..., kom. Gjilan, në pyllin shtetëror, në vendin e quajtur “ ... ” i pandehuri me qëllim të vjedhjes, me sharrë motorike , ka prerë 70 copa trungje të llojit bung, me masë të përgjithshme prej 2.90 m³ të cilat i ka bartë me traktor, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës ...– Zyra në Gjilan, në vlerë prej 371.20 €

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragr.1 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52, 73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 KPPK të pandehurit i shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

I. Të pandehurit i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1(një) viti, nuk kryen tjetër vepër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

II. E dëmtuara ... – Zyra në Gjilan, për realizimin e kërkesës pronësoro-juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën penale kundër të akuzuarit E.G. nga fsh. ..., kom. ..., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni nga neni 358 KPRK.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 29.03.2018 në të cilën është lexuar aktakuza e Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.130/18 e dt. 29.01.2018, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë. I pandehuri E.G.në mbrojtjen e tij deklaroi se e ka kryer veprën penale dhe se pendohet për këtë, ka premtuar se asnjëherë nuk do të kryej këtë apo çfarëdo vepre tjetër penale, i ka dy fëmijë të sëmure, njëri i paralizuar kurse tjetri i operuar, andaj, e lutë gjykatën që ta dënoj sa më butë, sepse është mbajtës i vetëm i familjes.

Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës kurse me vetë faktin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358.paragr.1 lidhur me nenin 31 KPRK.

Sipas nenit 358 paragr.1 lidhur me nenin 31 është paraparë “kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e drunjëve të prerë tejkalon dy (2) metra kub, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Bazuar në nenin 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri është baba i gjashtë fëmijëve, prej të cilëve dy janë të sëmurë, se është mbajtës i vetëm i familjes, i gjendjes së varfër ekonomike dhe se deri më tani nuk ka qenë i gjykuar. Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj vepre penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata në bazë të nenit 451 paragr.1 KPP, vendosi që të obligoj të pandehurin të paguaj vetem paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.100/2018 më dt. 29.03.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq, d.v.

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajllloviq, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

Përktheu –
Naile Keçmezi

